



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK BERAT

Berat,më / /2025

Raporti 6 mujor i realizimit te buxhetit 2025 te planifikuar për Këshillin Bashkiak.Berat.

Në funksion të ecurië së punës së Këshillit Bashkiak të qytetit të Beratit për gjashtë mujorin parë të vitit 2025, janë realizuar një pjesë e shpenzimeve të planifikuara në buxhetin vjetor të bashkisë. Këto shpenzime lidhen me pagesat e anëtarëve të këshillit, funksionimin administrativ dhe përmirësimin e kushteve të punës.

1. Pagesat për anëtarët e keshillit bashkiak.

Plani vjetor për periudhën: 9,300,000 lekë

Shpenzimi faktik për periudhën Janar-Qershor:3,915,796 lekë

Pagesat janë realizuar në përputhje me pjesëmarrjen aktive të këshilltarëve në mbledhjet e zhvilluara.

2. Paga e Sekretarit të Këshillit

Plan: 1,560,000lekë

Fakt: 636,213 lekë

Pagesa është realizuar në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me kontratën individuale të punës.(Përfshire mungesa/leje lindje)

3. Paga Specialist i Këshillit

Plan: 780,000 lekë

Fakt: 0 lekë

4. Shpenzime për kancelari dhe pajisje zyre

Plan: 205,000 lekë

Fakt: 87,000 lekë

Janë përfshirë blerje materialesh kancelarike, furnizime për sallën e mbledhjeve, toner printeri, letër, si dhe mjete ndihmëse për përgatitjen e dokumentacionit të mbledhjeve.

5. Shpenzime për dhurata ceremoniale (buqeta lulesh, kurora,)

Plan: 64,000 lekë

Fakt: 10,000 lekë

Janë përfshirë shpenzimet për blerjen e kurorave me lule për rastin e Ditës së Dëshmorëve 5 Maj 2025.

6. Shpenzime për mirëmbajtje pajisje kompjuterike

Plan: 60,000 lekë

Fakt: 10,000 lekë

Janë shpenzime për shërbime teknike gjatë mbledhjeve, mirëmbajtje të pajisjeve IT.

7. Blerje çertifikata, karta, kartolina urimi për festat zyrtare

Plan: 18,000 lekë

Fakt: 0 lekë

8. Shpenzime për konsultime (seance konsultimi me bashkësinë, dëgjesat publike, transparenca e informimit)

Plan: 80,000 lekë

Fakt: 0 lekë

Vlerësim dhe rekomandime

Shpenzimet për periudhën janar-qershor 2025 janë kryer në përputhje me planifikimin buxhetor dhe tregojnë një menaxhim të kujdesshëm të fondeve publike. Rekomandohet që edhe në vijim të vitit, të ruhet një qasje e njëjtë e transparencës përballë komunitetit lidhur me zërat e shpenzimeve..

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

Bora Agalliu

